

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-237/13**

Prishtine 12 Gusht 2015

Në çështjen juridike të:

**J. A.**

**Pala ankuese**

Kundër

Z. C. T.

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Elka Filcheva-Ermenkova anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012 të datës 29 Shkurt 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin nr.34036), pas seancës gjyqësore të mbajtur më 12 Gusht 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Pranohet ankesa e palës ankuese J. A. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/140/2012 (për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34036) të datës 29 Shkurt 2012.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/140/2012 (për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34036) të datës 29 Shkurt 2012.
3. Hidhet si e palejueshme kërkesa e Z. C. T. e regjistruar në AKP me numër KPA34036 për shkak të heqjes dore nga kërkesa .

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 Mars 2007, paraqitësja e kërkesës Z. C. T, ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr.187 me sipërfaqe prej 16ari 50m<sup>2</sup> që ndodhet në vendin e quajtur Rosuljapod nasipa, Zona Kadastrale Drobesh, Komuna e Vitise (në tekstin e mëtejshëm : Prona e kërkuar). Paraqitësja e kërkesës deklaron se babai i saj ishte pronar i pronës, e cila po përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona të panjohur dhe se posedimi i pronës ka humbur më 20 Qershor 1999 si rezultat i rrethanave të konfliktit të armatosur 98-99?. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA34036.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka depozituar pranë AKP dokumentet e mëposhtme:
  - Flete poseduese nr.36, date 16 Nëntor 2006, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Vitise, me ane të se cilës konstatohet se ngastra objekt kërkesë ndodhet në vendin e quajtur Rosuljapod nasipa, Zona Kadastrale Drobesh, Komuna e Vitise dhe është regjistruar në emrin e R. (J.) M, babai i paraqitëses së kërkesës si pronar i pronës së kërkuar;
  - Certificate e vdekjes së M. R., e lëshuar me date 9 Tetor 2006 nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Krusevac;

- Aktvendim i trashëgimisë T.nr.025-2008, date 21 Prill 2008, lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë, me ane te cilit vërtetohet se paraqitësja e kërkesës është trashëgimtare e ¼ te pronave te babait te saj;
- Certificate martese e Z. C. T. date 19 Shtator 2003 e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil ne Komunën e Vitisë.

Sipas Raportit të Konsoliduar të Verifikimit të AKP-së të datës 21 Janar 2009, të gjitha dokumentet e lartpërmendura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

3. Kërkesa për pronën është notifikuar fillimisht më 9 Gusht 2007. Me vone në datë 30 Gusht 2010, kërkesa është ri notifikuar përmes publikimit në Gazetën nr.7, e cila është lënë në fshat, në disa zyra komunale dhe në Zyrat e UNHCR-së dhe të Ombudspersonit. Kjo tregon se notifikimi i pare nuk ishte korrekt.
4. Asnjë pale përgjegjëse apo person i interesuar nuk është paraqitur pranë AKP-se.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronën e kërkuar, me vendimin e saj KPCC/D/A/140/2012 i datës 29 Shkurt 2012, që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34036, ka vendosur të konfirmojë te drejtën pronësore të paraqitëses së kërkesës për arsye se ka paraqitur prova te mjaftueshme për të provuar se është bartës aktual i se drejtës pronësore dhe se ka të drejtën e posedimit të asaj pronë.
6. Vendimi i është dorëzuar paraqitëses se kërkesës Z.C. T. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse ne ankese) më datë 28 Gusht 2012.
7. Më datë 7 Shkurt 2013 AKP-ja me kërkesë te paraqitëses se kërkesës vendosi nen administrimin e saj pronën e kërkuar.
8. Me kërkesë date 2 Korrik 2013 pala kërkuese paraqet një kërkesë pranë AKP-se për te mbyllur lëndën e paraqitur me arsyetimin se prona i është shitur palës se trete.
9. Me date 25 Korrik 2013, J.A. (ne tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka dorëzuar një ankim pranë AKP-se për vendimin KPCC/D/A/140/2012 i datës 29 Shkurt 2012.
10. Së bashku me ankesën pala ankuese ka paraqitur dokumentet ne vijim:
  - Kontrate mbi shitblerjen e paluajtshmerisë nr.1747/2008 date 19 Shtator 2008, te lidhur midis R. I., Z. T., S. P. dhe G. M., te përfaqësuar nga av. S. M. ne cilësinë e shitësit dhe J. A. ne cilësinë e bleresit. Kontrata është vërtetuar nga Gjykata Komunale ne Viti.

- Certificate mbi te drejtat e pronës se paluajtshme nr.P-70101021-00187-0, date 2 Prill 2013 lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale ne Viti, me ane te se cilës vërtetohet se J. A. është pronar i pronës se kërkuar.
- Kopje e planit nr.737/13, date 4 Shkurt 2013 te lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Prone dhe Gjeodezi.

### **Pretendimet e paleve**

11. Pala ankuese kundërshton vendimin e KKPK-së me arsyetimin se vendimi është marrë në mungese te provave dhe se ai disponon provat e nevojshme qe provojnë pronësinë e tij mbi pronën objekt kontesti.
- 12.Pala përgjegjëse ne ankese deklaroi se ka kërkuar qe çështja te mbyllet prej AKP-se, pasi e ka shitur pronën, si rrjedhoje nuk ka baze ligjore për paraqitjen e ankesës dhe se nuk është e nevojshme te zhvillohen procedura te tjera lidhur me këtë çështje.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

13. Sipas nenit 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, një palë mund të paraqesë një ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh që nga njoftimi i palëve nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës rreth vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
14. Bazuar ne dispozitën e mësipërme vetëm pala në procedurën në shkallë të parë ka të drejtë të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Sipas jurisprudencës të Kolegjit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm nga ky rregull ndodh vetëm nëse dhe kur personi që mund të pretendojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka qenë në dijeni për kërkesën e paraqitur në AKP për shkak të mungesës së njoftimit ne mënyrën e duhur dhe në këtë mënyrë nuk është në gjendje që të paraqes njoftimin për pjesëmarrjen.
- 15.Ne rastin konkret, bazuar ne faktet dhe provat e paraqitura Gjykata Supreme vëren se notifikimi i pare nuk ishte korrekt, prandaj është bërë notifikimi i ri përmes publikimit të kërkesës në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekje të arsyeshme” për ta bërë njoftimin për kërkesën sikurse parashikohet ne nenin 10.1 të rregullores vetëm në raste të veçanta. Një përjashtim i tillë nuk mund të gjendet në këtë lëndë, pasi gjykata nuk mund ta përjashtojë faktin se pala

ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën dhe për me tepër që pala ka depozituar prova të mjaftueshme për të provuar interesin e tij juridik, ndaj për këtë arsye ai duhet të pranohet si palë në procedurë. Ankesa e tij është e pranueshme.

### *Juridiksioni*

16. Pala përgjegjëse në ankese, në kërkesën e saj drejtuar AKP-se për të mbyllur kërkesën e saj si dhe në përgjigjen në ankese të paraqitur përpara Gjykatës Supreme, ka pranuar se prona është shitur dhe se nuk ka me arsye për procedura të tjera ligjore lidhur me këtë prone. Kjo deklaratë duhet të konsiderohet si tërheqje nga kërkesa në përputhje me nenet 149 dhe 198.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili është i aplikueshëm jo vetëm përpara KKPK-se por dhe në procedurat përpara kolegjit të apelit të AKP-se.
17. Në përputhje me nenet 149, 198 dhe 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore tërheqja nga kërkesa nënkupton se kërkesa duhet të hidhet. Kjo dispozitë mund të aplikohet pershtatmerishtë në këtë procedurë përpara kolegjit të ankesave të AKP-se siç parashikohet në seksionin 12.2 të Ligjit 03/L-079.
18. Pas tërheqjes së kërkesës, gjykata pa kryer ndonjë procedurë tjetër mund të marrë vendim për hedhjen e kërkesës nga e cila paraqitësi i kërkesës ka hequr dorë.
19. Në kuadër të procedurave përpara Kolegjit të Ankesave të AKP-se kjo nënkupton se gjykata duhet të pranojë ankesën dhe të anulohet vendimin e ankimuar duke hedhur poshtë kërkesën.

### *Konkluzion*

20. Në bazë të arsye të paraqitura e sipas nenit 198.1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore anulohet vendimi i KKPK-së dhe kërkesa hidhet poshtë si e papranueshme pasi pala përgjegjëse në ankese ka hequr dorë nga kërkesa.

### **Këshillë ligjore**

21. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**